



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:215495
Datë: 10.10.2024
Numri i dokumentit: 06279595

Ac.nr.3178/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike-kontestimore të paditësve L.F dhe B.M, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit F.B, avokate nga Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, Rr. “Luan Haradinaj” p.n., të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore – Avokati Shtetëror N.K, me objekt kontesti, kompensim i pagave të trembëdhjeta, duke vendosur në lidhje me ankesën e palës së paditur të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.7759/2021, i datës 24.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, Rr. “Luan Haradinaj” p.n., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.7759/2021, i datës 24.02.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.7759/2021, i datës 24.02.2023, ka vendosur si në vijim:

“I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve L.F dhe B.M, ashtu që: DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, që paditësve t’ua paguaj shumat si në vijim:

- Paditësit L.F, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019 dhe 2020, për secilin prej këtyre viteve t’ia paguaj shumën nga 579.74 €, apo shumën e përgjithshme prej 1,739.22 €.

- Paditësit B.M, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019 dhe 2020, për secilin prej këtyre viteve t’ia paguaj shumën nga 581.70 €, apo shumën e përgjithshme prej 1,745.10 €.

II. DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria Përgjithshme, në Prishtinë, të ju paguaj paditësve L.F dhe B.M, shumat e gjykuara si në pikën - I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit, e cila fillon të llogaritet nga data 27.09.2021, dita kur është paraqitur padia në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedure kontestimore, në shumën prej 197.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes - pranimit të këtij aktgjykimi”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur, përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës jokontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën t'a aprovojë si të bazuar, ta prishë aktgjykimin e shkallës së parë duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesën e të paditurës ka paraqitur paditësit duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e të paditurës me propozim që e njëjta të refuzohet si pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, më datë 27.09.2021, ka paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, ndërsa me datën 06.12.2021 ka paraqitur parashtrësë për plotësimin e padisë në kuptimin objektiv duke kërkuar nga gjykata që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e tyre, duke e detyruar të paditurën për kompensimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore të fundvitit, për vitet 2018,2019,2020, gjegjësisht për 3 vite të paguaj 3 paga, ashtu që: paditësit të parë L.F shumën e përgjithshme prej 1,739.22 €, apo për secilin vit nga 579.74 €, ndërsa për vitet e njëjta të lartcekura paditësit të dytë B.M, shumën përgjithshme prej 1,745.10 € apo për secilin vit nga 581.70 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8 % në vit, nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ndryshimit të saj, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi, në kuptim të nenit 8 e lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, jashtë seance ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.7759/2021, i datës 24.02.2023, me të cilin e ka aprovuar në tërësi të themeltë kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nuk është kontestues fakti se paditësit janë të punësuar tek e paditura, pasi kjo është vërtetuar në bazë të vërtetimit të punësimit, ndërsa pagën për periudhën kohore për të cilën e kanë parashtruar padinë

e kanë bazuar në vërtetimin e punësimit të lëshuar nga e paditura. Po ashtu gjykata ka vërtetuar faktin e punësimit të paditësit te e paditura, pagën e muajit dhjetor për vitet 2018, 2019 dhe 2020 në bazë të listës së pagave, vlerësimin e performancës së paditësit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 janë vlerësuar me vlerësim të kënaqshëm.

Tutje gjykata e shkallës së parë ka shtuar se e paditura ka pasur detyrim që paditësit si të punësuar të saj t'iu paguaj pagën e 13-të për çdo fund vit, pasi janë plotësuar kushtet nga ana e paditësve si parashihen me nenin 29 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 si dhe nenit 30 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2021, me saktësisht, vlerësimi i performancës për vitet 2018, 2019 dhe 2020, e po ashtu ndaj të njëjtëve nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Vendimin e ka bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka marrë konform nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Sa i përket pretendimit ankimor se kërkesëpadsia e paditësve është parashkruar, kjo gjykatë vlerësoi se një pretendim të tillë e paditura nuk e ka parashtruar gjatë përgjigjes në padi të cilën gjykata e shkallës së parë e kishte ftuar që të paraqesë andaj meqenëse kjo nuk e ka paraqitur përgjigjen në padi tani një pretendim i tillë nuk mund të paraqitet në ankesë, ngase sipas nenit 180.3 të LPK-së, parashihet se *“Prapësimi i parashkrimit dhe prapësim me qëllim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë”*, andaj një pretendim i tillë është në kundërshtim me dispozitën e lartcekur.

Nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi është nxjerr pa u plotësuar kondita ligjore në kuptim të nenit 398 të LPK-së, sepse në rastin konkret janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për marrjen e të njëjtit sipas nenit 152 lidhur me nenin 398 të LPK-se.

Në raport me pretendimin për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike po ashtu kjo nuk qëndron sepse nga provat e administruara dhe vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë vërtetuar këto fakte: punësimi i paditësit tek e paditura, vlerësimi pozitiv i paditësve nga e paditura për vitet 2018, 2019 dhe 2020 dhe mungesa e shqiptimit të ndonjë masë në procedurë disiplinore, lartësia e pagave është vërtetuar me dokument zyrtar siç është lista e pagave dhe është bazuar në pagën e muajit dhjetor për vitet kontestuese (ku në bazë të listës së pagave vërtetohet se shumica e përgjithshme për tri vitet 2018, 2019 dhe 2020 është shumica si ne dispozitiv të aktgjyqimit të atakuar), e paditura nuk ka arritur të provojë se i'a ka kompensuar paditësve pagat e kërkuara.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e procedurës nga neni 78 dhe 79 i Ligjit të Punës, pasi kërkesa e paditësit nuk hyn në kategorinë e çështjeve për tu ngritur konform nenit 78 fillimisht te e paditura e më pastaj konform nenit 79 në gjykatë, për arsye se nga ana e punëdhënësit nuk ka ndonjë vendim paraprak të cilin do t'a godiste paditësin, por ka detyrim të përmbushjes nga ana e të paditurës.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale pasi që me udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës dhe atë me nenin 29.1 tek e drejta në pagë dhe e shpërblimit, përcaktohet se *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, ndërsa me të njëjtin, nen paragrafi 2. përcaktohet se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*.

Paditësit i plotësojnë kushtet për të përfituar një kompensim të tillë, pasi që janë në marrëdhënie pune tek e paditura, nuk kanë pasur masë disiplinore të shqiptuar për vitet kontestueses, 2018, 2019 dhe 2020, ndërsa kanë pasur vlerësim të mirë për këto vite, lartësia e pagës është përcaktuar në bazë të listës së pagave për vitet, 2018, 2019 dhe 2020 si dokument publik lëshuar nga e paditura.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t'i shmanget detyrimit për përmbushje. Fakti se nuk është bërë përmbushja në procedurë të brendshme administrative nuk nënkupton mungesë të bazës juridike për t'u detyruar nga gjykata për përmbushje.

Lidhur me kamatën është vendosur konform nenit 382 të LMD-së, ku përcaktohet lartësia prej 8% në vit nga dita e paraqitjes së padisë pasi bëhet fjalë për dëm material.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e 452.1 të LPK-së.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3178/2023, me datë 04.10.2024

Kryetari i kolegjit
Qerim Ademaj, d.v